

DEKRET
Nr. 8213, datë 3.6.2013

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR KOMUNE, KOMUNA SEVASTER, QARKU VLORË

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr. 10 019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar),

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 23 qershor 2013, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të komunës Sevaster, qarku Vlorë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani